



NEWSLETTER E DIASPORËS



PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#124

Agjencia Kombëtare e Diasporës ju prezanton me databazën e studentëve



Jeni një student shqiptar që po studion jashtë vendit?

Jeni një shtetas i huaj me origjinë shqiptare që po studion jashtë vendit?

Agjencia Kombëtare e Diasporës ju prezanton me databazën e studentëve.

Kjo është një nismë e cila do të ketë në fokus rritjen e ndërveprimit me studentët duke lehtësuar komunikimin mes tyre.

Ju ftojmë të bëheni pjesë e kësaj platforme!

Agjencia Kombëtare e Diasporës ju mirëpret!



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimim e dokumentave të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

Agjencia Kombëtare e Diasporës bëhet pjesë dhe partnere e projektit "Qëndrueshmëria Margjinale: Modeli i Ekonomisë Qarkulluese për Zhvillimin e Vokacioneve Territoriale"

Agjencia Kombëtare e Diasporës bëhet pjesë dhe partnere e projektit "Qëndrueshmëria Margjinale: Modeli i Ekonomisë Qarkulluese për Zhvillimin e Vokacioneve Territoriale" në bashkëpunim me Agjencinë Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Në takim me Z. Claudio Poligniano, Drejtues i Zyrës së Bashkëpunimit për Regione Puglia në Tiranë, Drejtoresha e Diasporës, Znj. Hasanllari theksoi se për Agjencinë Kombëtare të Diasporës ka një rol të jashtëzakonshëm përfshirja e komunitetit arbëresh në jetën ekonomike të vendit. Agjencia, si institucion përgjegjës për diasporën ka kënaqësinë të jetë pjesë e programeve të tilla që fuqizojnë edhe më shumë marrëdhëniet mes diasporës dhe vendit të origjinës!



Aplikacioni "Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare" zëri i biznesit në Diasporë

Gjithçka në "pëllëmbë të dorës" nëpërmjet aplikacionit "Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare - ADBC". Informacion të arritshëm për bizneset, sipërmarrësit, anëtarët e Diasporës në Shqipëri, si dhe funksione të ndryshme

Qendra e Botimeve për Diasporën boton falas online "Mësojmë Shqip, Niveli A2"



Qendra e Botimeve për Diasporën, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Fakultetin e Historisë e të Filologjisë të Universitetit të Tiranës të miratuar me vendim të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën, Nr. 160 Prot., datë 16.04.2020 "Për miratimin e krijimit të Platformës online për mësimdhënien e gjuhës shqipe në Diasporë", boton online falas "Mësojmë Shqip, Niveli A2", tekstin më të ri didaktik për mësimdhënien e gjuhës shqipe në diasporën, hartuar nga Prof. Dr. Aljula Jubani, Dr. Adriana Fishta-Bejko, Prof. As. Dr. Linda Mëniku.

Ky tekst "Mësojmë Shqip, Niveli A2" i hartuar në harmoni me programin e kurrikulës së përbashkët të miratuar nga Ministritë e Arsimit të Shqipërisë dhe Kosovës, merr parasysh specifikat e nxënësve prej të cilëve do të përdoret dhe vjen në kuadër të "Mëso shqip", një paketë e dobishme e cilësore didaktike, e cila përmban 8 tekste didaktike ku përfshihen librat e mësuesit dhe materiale të tjera plotësuese.




Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

Qendra e Botimeve për Diasporën boton falas online "Mësojmë Shqip, Niveli A1"

Qendra e Botimeve për Diasporën, boton online falas "Mësojmë Shqip, Niveli A1", tekstin më të ri didaktik për mësimdhënien e gjuhës shqipe në diasporën. Ky tekst "Mësojmë Shqip, Niveli A1" i hartuar në harmoni me programin e kurrikulës së përbashkët të miratuar nga Ministritë e Arsimit të Shqipërisë dhe Kosovës, merr parasysh specifikat e nxënësve prej të cilëve do të përdoret dhe vjen në kuadër të "Mëso shqip", një paketë e dobishme e cilësore didaktike, e cila përmban 8 tekste didaktike ku përfshihen librat e mësuesit dhe materiale të tjera plotësuese.

Materialet letrare të përzgjedhura në këto tekste e ndihmojnë nxënësin të ndërmarrë një rrugëtim letrar nëpër temat e mëdha të botës shqiptare, siç janë ato të vendlindjes e atdheut, të gjuhës amtare, të vetëdijes identitare, të trashëgimisë kulturore e gjuhësore etj.

"Mësojmë Shqip, Niveli A1", botuar nga Qendra e Botimeve për Diasporën, mund ta shkarkoni falas online.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë



Diaspora Shqiptare

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS

App store: këtu Play store: këtu



Burgu nuk është vetëm një vend për vuajtjen e dënimit, por mund të jetë edhe letërsi, studim, rritje e njohjeve kulturore dhe ndërveprim. Nisma "Dhuro libra" do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.



Digjitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen